



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

RAPORT
I VLERËSIMIT TË PËRSHTATSHMËRISË
SË SISTEMIT TË FINANCIMIT TË KOMUNAVE
PËR VITIN 2016

Prishtinë, shkurt 2017

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Vendimet e Komisionit të Granteve për vitin 2016	3
3. Vlerësimi i përshtatshmërisë së granteve për komuna për vitin 2016	3
a) Granti i përgjithshëm	4
b) Granti specifik i arsimit.....	4
c) Granti specifik i shëndetësisë	5
d) Të hyrat vetanake komunale.....	5
4. Rekomandimet e Komisionit të Granteve	6

1. Hyrje

Ky raport prezanton vlerësimet e Komisionit të Granteve, bazuar në mbledhjen e datës 03.02.2017, të përshtatshmërisë së sistemit të financimit të komunave për vitin 2016. Raporti gjithashtu përmban sfidat kryesore të identifikuara nga Komisioni i Granteve, si dhe ofron rekomandime për përmirësime të mëtutjeshme në sistemin e financimit komunal.

Vlerësimet e Komisionit të Granteve bazohet në parimet e financimit komunal të përcaktuar me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVQL).

2. Vendimet e Komisionit të Granteve për vitin 2016

Për vitin 2016, Komisioni i Granteve ka aprovuar grantet qeveritare për financimin e komunave, si vijon:

- Granti i Përgjithshëm në shumën 134.91 milionë euro;
- Granti Specifik për Arsim në shumën 161.33 milionë euro;
- Granti Specifik për Shëndetësi në shumën 42.08 milionë euro;
- Financimi për Shëndetësi Sekondare në shumën 2.6 milionë euro dhe
- Financimi për Shërbime Rezidenciale në shumën në shumë prej 0.24 milionë euro.
- Përfshirjen e parashikimit të të hyrave vetanake komunale në buxhetin e shtetit në shumë prej 80 milionë euro.

3. Vlerësimi i përshtatshmërisë së granteve për komuna për vitin 2016

a) Granti i përgjithshëm

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal përcakton parimet, kriteret dhe formulat bazë për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna. Granti i përgjithshëm me sistem të mbyllur llogaritet me pjesëmarrje prej 10 për qind të të hyrave të projektuara të buxhetit të përgjithshëm, duke përjashtuar disa të hyra të njehershme dhe disa të hyra të tjera.

Në vitin 2016, Ligji i Financave Lokale është amendamentuar dhe u ka mundësuar 14 komunave që kanë më pak se 22,000 banorë, më shumë resurse financiare. Kjo gjë është bërë e mundur duke bërë rishpërndarjen e 2.7% të grantit të përgjithshëm te këto komuna për t'iu mundësuar këtyre komunave ofrimin e shërbimeve minimale për qytetarë, meqë formula e financimit komunal rezultonte në buxhet të pamjaftueshëm për këto komuna për shkak të numrit të vogël të banorëve.

Gjithashtu, komunat kanë hasur në probleme për të financuar shërbimet e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe për të paguar obligimet ndaj ndërmarrjeve publike. Për këtë arsye, nevojitet një fleksibilitet më i madh i komunave në planifikimin e shpenzimeve operative, duke mos përfshirë këtu kategorinë paga dhe mëditje.

Komunat gjithashtu kanë ngritur problemin e planifikimit të hyrave nga taksa komunale për mbeturina.

Komisioni i Granteve rekomandon që komunat të kenë fleksibilitet në planifikimin e shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për të qenë në gjendje të bëjnë kontraktimin e operatorëve për grumbullimin e mbeturinave.

Një tjetër çështje që komunat e kanë ngritur si shqetësim dhe që kërkon zgjidhje është edhe çështja e disa kompetencave që janë centralizuar, por që buxheti i tyre ka mbetur në nivel komunal si shërbimi i zjarrfikësve, inspektorët sanitar, inspektorët e tregut, etj.

b) Granti specifik i arsimit

Granti specifik i arsimit është me sistem të hapur dhe bazohet në ofrimin e shërbimeve në sektorin e arsimit parauniversitar bazuar në mundësitë buxhetore.

Komisioni i Granteve vlerëson se përcaktimi i grantit specifik arsimor duhet të paraprihet nga një analizë më e detajuar për ofrimin e shërbimeve arsimore duke përfshirë statistika më të sakta demografike dhe duke marrë parasysh specifikat e komunave.

Komisioni i Granteve ka vlerësuar se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të fokusohet në politikat arsimore dhe në cilësinë e arsimit, kurse komunat të fokusohen në

infrastrukturën shkollore. Komisioni i Granteve ka përkrahur qëndrimin e MASHT që në periudhën afatmesme të bëhet gradimi i arsimtarëve në katër nivele dhe rrjedhimisht edhe niveli i pagave të përshtatet me këtë gradim.

c) Granti specifik i shëndetësisë

Granti specifik i shëndetësisë është me sistem të hapur dhe bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore bazuar në mundësitë buxhetore.

Është treguar në praktikë se përcaktimi i grantit specifik shëndetësor i bazuar në metodën e thjeshtuar për kokë banori është më i qartë, më i thjeshtë dhe jodiskriminues. Komisioni i Granteve vlerëson se përcaktimi i grantit specifik shëndetësor duhet të paraprihet nga një analizë më e detajuar e ofrimit të shërbimeve shëndetësore si dhe me statistika demografike sa më të sakta lidhur me kujdesin shëndetësor.

d) Të hyrat vetanake komunale

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka autorizuar komunat që të bëjnë përcaktimin, administrimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake komunale. Komunat kanë shfrytëzuar autoritetin e tyre për të planifikuar dhe inkasuar të hyrat vetanake nga një numër i madh burimesh financiare të lejuara me ligj. Komunat gjithashtu zhvillojnë aktivitete komerciale, veçmas për prona të patundshme që mund të gjenerojnë të ardhura vetanake.

Bazuar në nivelin e inkasimit real të të hyrave vetanake komunale në vitet e kaluara, Komisioni i Granteve konkludon se niveli i projeksionit të të hyrave komunale vetanake nuk duhet të mbivlerësohet, por duhet të bazohet në potencialin e komunave nga të hyrat e rregullta në tri vitet e kaluara me një rritje të lehtë vjetore për të rritur qëndrueshmërinë e financimit të komunave.

4. Rekomandimet e Komisionit të Granteve

Për të siguruar se granti i përgjithshëm shpërndahet më drejtë dhe merr parasysh specifikat e komunave, Komisioni i Granteve rekomandon që Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) të bëjë vlerësimin e saktë të popullsisë sipas komunave. Këto të dhëna duhet të përdoren në ndarjet e ardhshme të grantit të përgjithshëm.

Për të rritur përshtatshmërinë e ndarjes së grantit specifik të arsimit, Komisioni i Granteve rekomandon si në vijim:

- Zbatimin efikas të Sistemit të Menaxhimit të Informatave nga MASHT përmes Drejtorive Komunale të Arsimit për raportimin e statistikave bazë në Arsimin parauniversitar;
- MASHT-i, në pajtim me mandatin e përcaktuar ligjor, duhet të zhvillojë kapacitetet e nevojshme për shpërndarjen në kohë të standardeve arsimore, parametrave të formulës, si dhe të inpleteve mbështetëse të parashikuara në LFPL. Specifikat individuale të komunave duhet trajtuar në veçanti;
- Saktësia dhe disponueshmëria e statistikave të arsimit me kohë duhet të sigurohet nga MASHT për të gjitha Drejtoritë Komunale të Arsimit, duke përfshirë komunitetet pakicë;
- MASHT të fokusohet në politikat arsimore dhe cilësinë e arsimit, kurse komunat në infrastrukturën shkollore.
- Në periudhën afatmesme të bëhet gradimi i mësimdhënësve në katër nivele.

Për përmirësimin e financimit sektorial përmes grantit specifik për shëndetësi, Komisioni i Granteve rekomandon që:

- Ministria e Shëndetësisë të sigurojë zbatimin real dhe efikas të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në shëndetësinë primare dhe sekondare, duke përfshirë raportimin e statistikave bazë demografike,
- Ministria e Shëndetësisë propozon grantin specifik për shëndetësi sipas kriterit për kokë banori,

Gjithashtu, Komisioni i Granteve rekomandon si në vijim:

- Që qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave për nivelin komunal të specifikojnë strukturën e shpenzimeve buxhetore komunale për kategoritë e shpenzimeve kapitale dhe për paga dhe mëditje, kurse t'iu lejoj komunave më shumë fleksibilitet në planifikimin e shpenzimeve në kategoritë e tjera operative (mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, dhe subvencione dhe transfere).
- Projektioni i të hyrave vetanake komunale bëhet në baza reale dhe duke marrë parasysh historinë e inkasimit të të hyrave vetanake komunale në tri vitet e kaluara, por duke vendosur një objektiv real të rritjes për çdo vit për çdo komunë me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë të financimit të komunave.
- Komunat të kenë të drejtë të planifikojnë të hyrat nga taksa komunale për mbeturina. Rrjedhimisht, komunat të kenë fleksibilitet në planifikimin e shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për të qenë në gjendje të bëjnë kontraktimin e operatorëve për grumbullimin dhe dërgimin e mbeturinave në destinacionet përkatëse të lejuara me ligj.
- Fondi për pagesën e pushimeve të lehonisë të kaloj nga buxheti komunal tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Llogaritja e buxhetit për pagesën e përvojës së punës të jetë më e saktë.
- Komunat të jenë të kujdesshme për implikimet buxhetore të akteve ligjore dhe nënligjore që aprovohen në institucionet qendrore dhe ato t'i planifikojnë me kohë.